

09-08-2023

Komunikimi i drejtpërdrejtë me profesionistë të shëndetësor (KDPSH)

Ozempic® (semaglutid) dhe Saxenda® (liraglutid): Barna/medikamente të falsifikuara

I/e nderuar Profesionist/e i/e Shëndetësor,

Novo Nordisk Pharma Operations A/S Dega në Kosovë ka pranuar ankesa të shumta në lidhje me produkte të dyshimta në Lindjen e Mesme dhe Rusi. Deri më tani, hetimet tregojnë se një analog i insulinës me veprim të shpejtë i indikuar për përmirësimin e kontrollit të glicemisë tek të rriturit dhe pacientët pediatrikë me diabet mellitus, është rietiketuar dhe shitur si Novo Nordisk Ozempic® dhe Saxenda®. Kjo është një çështje kritike që mund të ndikojë në sigurinë e pacientëve, prandaj Novo Nordisk po e heton këtë çështje me kujdesin e duhur së bashku me autoritetet shëndetësore.

Identifikimi i produkteve të falsifikuara mund të jetë i vështirë, vetëm se shkallëzimi në lapsin e falsifikuar shkon nga 0 në 80 dhe përzgjedhësi i dozës zgjatet kur vendoset doza. Kjo është e ndryshme nga lapsat origjinalë Novo Nordisk Ozempic® dhe Saxenda®. Lapsi origjinal Novo Nordisk nuk zgjatet dhe nuk rritet në gjatësi kur vendosni dozën, për më tepër rrotulluesja e dozimit është me doza fikse sipas udhëzimeve për përdorim. Shihni fotot më poshtë.

Produktet e falsifikuara janë blerë në barnatore tradicionale, barnatore të spitaleve, barnatore online, si dhe përmes kanaleve të paligjshme të shpërndarjes, që do të thotë se produktet e falsifikuara shiten si në zinxhirët e ligjshëm të shpërndarjes ashtu edhe ata të paligjshëm.

Ju kërkojmë me dashamirësi që të na mbështesni për të siguruar që pacientët që përdorin Ozempic® Saxenda® të vihen në dijeni se fatkeqësisht produktet e falsifikuara mund të gjenden në treg, si dhe që pacientët të jenë të kujdesshëm kur blejnë produkte. Në rast dyshimi për medikament të falsifikuar, ju lutemi t'i paralajmëroni pacientët tuaj që të mos ta përdorin barin.

Thirrje për raportim

Çdo informatë e detajuar rreth produkteve të falsifikuara do të jetë me rëndësi të madhe për Novo Nordisk. Në mënyrë që produktet e falsifikuara të mund të gjurmohen, ju lutemi ta raportoni menjëherë në Novo Nordisk Pharma Operations A/S Dega në Kosovë ose tek autoritetet shëndetësore si Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe Inspektoriati Farmaceutik, çdo bari të falsifikuar, si dhe efektet e padëshiruara të mundshme, duke përfshirë gabimet e mjekimit në lidhje me Ozempic® dhe Saxenda®.


Ju lutemi vini re se të gjitha raportet e pranuar për produkte të falsifikuara trajtohen me rëndësinë më të madhe dhe potencialisht do të ndiqen veprime juridike me autoritetet lokale.

Pika e Kontaktit e Kompanisë

Informata të mëtejshme mund të merren duke kontaktuar
Novo Nordisk Pharma Operations A/S Dega në Kosovë
Telefon: +383 38725681
Email: koprsafety@novonordisk.com

Sinqerisht,

Mr.ph.Abdelnaser Çuni
Person i Kualifikuar për Farmakovigjilencë





Example 1: Genuine Ozempic® pen
Shembull 1: laps original Ozempic®



Example 2: Genuine Saxenda® pen
Shembull 2: laps original Saxenda®



Example 3: Falsified Ozempic® pen
Shembull 3: Laps i falsifikuar Ozempic®